

VENDIM
Nr. 5, datë 4.5.2022

**PËR MIRATIMIN E MARZHEVE NË BAZË TË MONITORIMIT TË ÇMIMEVE
PËR PRODUKTET USHQIMORE BAZË DHE PRODUKTET E TJERA TË LIDHURA
ME TO, SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG**

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, në zbatim të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”,

VENDOSI:

1. Miratimin e marzheve që do të aplikohet për produktin ushqimor bazë miell masiv, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar nga rritja e çmimeve ndërkombëtare.
2. Për artikullin miell masiv miratohen marzhet si më poshtë:
 - a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të miellit nga prodhuesi dhe ambalazhuesi 33.3% e kostos së grurit të importuar, ose 20 lekë/kg. Ky marzh mbulon edhe kostot e përpunimit të grurit, prodhimin e miellit dhe ambalazhimit të tij;
 - b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të miellit 5% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerë 4 lekë/kg.
3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë/pakicë produktin e përcaktuar në këtë vendim.
4. Në pasqyrën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi jepen të dhënat në lidhje me përlogaritjet e çmimit të tregtimit sipas marzheve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën 4.5.2022 dhe i shtrin efektet deri në mbledhjen e ardhshme të Bordit. Ky vendim do të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Ceno Klosi, Genti Gazheli, Nikolla Lera, Vjollca Ferra, Gentian Celo, Ermal Babameto, Frida Krifca, Irfan Tarelli, Jeta Deda, Fuad Haxhiymeri, Elona Hametaj Mema, Majlinda Bajraktari

PASQYRA NR. 1

Përshkrimi	Kosto në import dhe pagesa në doganë	Marzhi në import/shumicë		Marzhi me pakicë		Çmimi i shitjes me pakicë	Sqarime
		%	vlerë	%	vlerë		
Miell	60 lekë/kg	33.3%	20 lekë/kg	5%	4 lekë/kg	84 lekë/kg	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e zhdoganimeve gjatë datave 23–29 prill 2022, si dhe zhdoganimet me peshë të lartë gjatë muajit prill, duke qenë se sasia e zhdoganuar gjatë javës së fundit është e ulët. Marzhi i shumicës mbulon kostot e përpunimit të grurit dhe prodhimit të miellit, ambalazhimit, frot ligjore, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar.